



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

II
4576

Nr. _____
Br. _____
No. _____
Nr i fq. _____
Br.Str. _____
No. pg. _____

Data: _____
Datum: 06. 10. 2025
Date: _____

Prishtinë / Pristina

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës: Br. predmeta : Case Number:	C-IV-25-0040	03/10/2025	
Titulli i dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document name:	Datë/Datum/Dated:
Aktvendim			04/09/2025
Për	Za	To	Agjencia Kosovare e Privatizimit Rr, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë
Pranuar nga	Primio:	Recived	
Titulli	Zvanje:	Title	
Data	Datum:	Date	06. 10. 2025
Nënshkrimi	Potpis:	Signature	

L.Mxh.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:134621

Datë: 04.09.2025

Numri i dokumentit: 07702078

C-IV-25-0040

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL), i Ndërmarrjes Shoqërore “Kooperativa Bujqësore Novobërda” (GJI142)
në likuidim - Novobërdë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr. “Dritan Hoxha” nr.55 Lakërishte, Prishtinë.

Për: Parashtruesin e kërkesës

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme). gjyqtarja Luljeta Maxhuni, me datën 04.09.2025, lëshon këtë:

AKTVENDIM

I. Aprovohet Raporti Përfundimtar i Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore “Novobërda” në Novobërdë.

II. Lejohet mbyllja e rastit të likuidimit ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore “Novobërda” në Novobërdë.

III. Lirohet Autoriteti i Likuidimit nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.

IV. Parashtruesi i kërkesës ka paguar taksen gjyqësore.



Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datën 03.07.2025, parashtruesi i kërkesës - Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme Raportin Përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore "Novobërda" (GJI142) në likuidim, Novobërdë, pasi që është ardhur në përfundim që ndërmarrja në fjalë nuk ka asete të realizueshme si dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat kreditore të vlefshme në bazë të nenit 40 të Ligjit 04/L-034 si dhe vërtetimit se nuk ka ankesa të regjistruara në Dhomën e Posaçme, parashtruesi i kërkesës ka propozuar që konform nenit 43 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe në pajtim me nenin 46 të këtij ligji, pas shqyrtimit të kërkesës të aprovojë Raportin Përfundimtar të Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore "Novobërda" (GJI142)" dhe të marrë vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje.

Për detaje të tjera referoju dosjes së lëndës.

Arsvetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

Paragrafi 2 i nenit 43 përcakton se, Raporti Përfundimtar përmban: 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera, 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme, 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,.... dhe 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit.

Paragrafi 3 i shtojcës së Ligjit bazik po ashtu i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) përcakton se: Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes.



Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Autoriteti i Likuidimit ka dorëzuar Raportin Përfundimtar për aprovim përfshirë dëshmitë në vijim që janë shqyrtuar nga gjykata.

Me vendimin e Bordit të Drejtoreshave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 07 maj 2014, është vendosur fillimi i procedurave të likuidimit duke përfshirë emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të Kooperativës Bujqësore "Novobërda" i cili ka hyrë në fuqi me datën 9 qershor 2014, sipas autoritetit të dhënë me vendimin e Bordit të Drejtoreshave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit emërimet i anëtarëve të parë të Autoritetit të Likuidimit GJI142 BB Novobërdë, FI 1584/90 : FI -11009/93- përbërja e të cilit kishte ndryshuar disa here - (Shtojca 2 dhe 4 Raportit të Përfunduar).

Në qershor të vitit 2014, Autoriteti i Likuidimit ka publikuar njoftimet e para për fillimin e procesit të likuidimit në gazetën Koha Ditore, Kosova Sot në Kosovë dhe gazeta Danas dhe Vijesnik në Serbi dhe Mal të Zi – (Shtojca 5 e Raportit të Përfunduar).

Me datën 19 qershor 2014, Autoriteti i Likuidimit ka dërguar njoftimet përkatëse për fillimin e Likuidimit të kësaj ndërmarrje shoqërore tek të gjithë kreditorët e njohur dhe potencial.

Me datën 19 qershor 2014, ka dërguar njoftimet për fillimin e Likuidimit të kësaj ndërmarrje shoqërore gjykatave si në vijim: Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës Apelit, Gjykatës Themelore Prishtinë –Departamentit për Çështje Ekonomike, Gjykatës Komunale Gjilan dhe Gjykatës Komunale Gjilan- Dega Novobërdë-(Kopjet janë të paraqitura në shtojcën 5 të Raportit të Përfunduar).

Me datën 19 qershor 2024, ka dërguar njoftimet për fillimin e Likuidimit të kësaj ndërmarrje shoqërore bankave si në vijim: ProCredit Bank – dega në Gjilan, Raiffeisen Bank – dega Gjilan, Banka Ekonomike-dega Gjilan, Banka për Biznes – dega Gjilan dhe Teb Banka- dega Gjilan dhe NLB Bank- dega Kaçanik-(Shtojca 6 e Raportit të Përfunduar).

Autoriteti i Likuidimit ka marrë konfirmimet nga Administrata Tatimore se kjo ndërmarrje shoqërore nuk ka obligime tatimore, nga Drejtoria e për Buxhet dhe Financa – komuna e Novobërdës se nuk ka



obligime tatimore të tatimit në prone si dhe nga Administrata Kadastrale e Kosovës se nuk ka pronësi të KB Novobërda, nuk evidentohet asnjë njësi kadastrale- (Shtojca 11, 12 dhe 13 e Raportit të Përfunduar)

Brenda afatit ligjor të paraparë për parashtrim e ankesave, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Likuidim nuk ka pranuar ndonjë ankesë lidhur me vendimet e Komisionit për Likuidim të kësaj ndërmarrje shoqërore.

Me datën 26 shkurt 2024, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Suprme ka konfirmuar se nuk ka ndonjë padi ndaj kësaj ndërmarrje shoqërore (Shtojca 9 e Raportit të Përfunduar).

Autoriteti i Likuidimit i Ndërmarrjes Shoqërore Kooperative Bujqësore "Novobërda" (GJI142) në likuidim, Novobërdë, ka identifikuar se kjo ndërmarrje kishte në pronësi: ngastrën kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 11.645 m² (1ha, 16 ari dhe 45 m²): oborrin prej 11, 436 m² dhe objektin (p+1 me sipërfaqe prej 209 m², zona kadastrale Jesenovik, komuna Novobërdë. Aseti në fjalë është privatizuar përmes shitjes me likuidim, në shumën prej 29.112 euro dhe kontrata është dorëzuar tek blerësi me datën 14 dhjetor 2023 (Shtojca 8 e Raportit të Përfunduar).

Gjatë afatit ligjor për paraqitjen e kërkesave kreditore nuk janë parashtruar kërkesa kreditore kundër kësaj ndërmarrjes andaj duke pas parasysh që nuk ka kreditor për tu paguar dhe pas mbulimeve të shpenzimeve të procedurës së likuidimit, si dhe pas transferimit të 20% të punëtorët e kooperativës Bujqësore "Novobërda në shumën prej 5.822.40 euro, fondet e mbetura do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të hyrat nga privatizimi konkretisht shita e aseteve përmes likuidimit janë njëzet e nëntë mijë e njëqind e dymbëdhjetë euro (29.112 euro), të ardhura nga qiraja gjatë procesit të likuidimit janë 1.365 euro ndërsa shpenzimet e likuidimit kane arritur vlerën prej 1. 544,64 euro që përfshin shpenzimet e njoftimeve për fillimin e likuidimit dhe shpenzimet tjera operative. Në bazë të pasqyrës përmbledhëse financiare të llogarisë bankare në likuidim parat e mbetura në llogari bankare janë 29.112 euro (Shtojca 9 e Raportit të Përfunduar).

Tutje, Parashtruesi ka deklaruar se shuma e parave në mirëbesim të likuidimit, apo që gjinden në llogaritë rrjedhëse në bankë është 29.112 euro dhe se kjo shumë do të përdoret në të ardhmen për të mbuluar shpenzimet eventuale në lidhje me procedurat e mbylljes së NSH-së dhe pas përfundimit të këtyre procedurave, fondet e mbetura do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës. (Shtojca 9 e Raportit të Përfunduar).



Gjykata konstaton se Agjencia Kosovare e Privatizimit përkatësisht Autoriteti i Likuidimit i ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe vendimet e nevojshme për mbylljen e rasti të likuidimit të kësaj Ndërmarrjes Shoqërore, në pajtim me ligjin, andaj aprovon Raportin Përfundimtar të Ndërmarrjes Shoqërore Kooperativa Bujqësore "Novobërda" dhe lejon mbylljen e rasti të likuidimit të kësaj Ndërmarrjes Shoqërore.

Me këtë ndërpritet ekzistimi i kësaj ndërmarrje dhe rasti mbyllet.

Autoriteti i Likuidimit mbetet më tej përgjegjës për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij, sipas nenit 46.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës, ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk caktohen taksa shtesë në këtë procedurë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarë

Luljeta Maxhuni

